

LIGJ
Nr. 115/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9584, DATË 17.7.2006 “PËR PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 pika 1, fjalët “Avokati i Prokurimeve” hiqen dhe shtohen fjalët “Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Neni 2

Në klasifikimin “D” të lidhjes nr. 1, që përmendet në nenin 4, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- | | |
|--|--------|
| 1. Pika 9 ndryshohet si më poshtë: | |
| “9. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | 0,6;”. |
| 2. Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje: | |
| “10. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi | 0,6.”. |

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe për komisionerët e përmendur në nenin 1 të këtij ligji i shtrin efektet financiare nga data e emërimit në detyrë.

Miratuar në datën 11.4.2013

Shpallur me dekretin nr. 8105, datë 18.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani